

ProRetail

Sistemi i menaxhimit në Internet



ProRetail
(Sistemi i Menaxhimit në Internet)

është një software i cili kryen menaxhimin e aktiviteteve tregtare me disa pika shitje dhe magazina në distancë.

Mund të përdoret njëkohësisht nga disa terminale të cilat janë të lidhura nëpërmjet rrjetit të Internetit.

aplikohet

ProRetail është një sistem shumë praktik dhe ndihmon për ta bërë më të lehtë e më të sigurtë menaxhimin e aktiviteteve tregtare me shumë terminale në largësi njëra tjetra.

Mund të aplikohet shumë mirë nga kompanitë që kanë ambiente shitje të shpërndarë në destinacione të ndryshme ose duan të menaxhojnë nga distanca pikat e shitjes, porositë, magazinë

Përshkrim i sistemit

Sistemi përdor një strukturë qendrore për ruajtjen e të dhënave në të cilën mbahen të gjitha rekordet. Këto të dhëna aksesohen në distancë nga Interneti nëpërmjet Web Servisit të ngritur për këtë qëllim.

Kjo strukturë i lejon të gjithë përdoruesve të sistemit si në përmjet programit të instaluar apo nëpërmjet moduleve në WEB të menaxhojnë on line dhe në kohe reale të gjitha të dhënat.

Në të gjitha kompjuterat ku do të menaxhohet sistemi do të instalohet programi klient ProRetail. Këto do të komunikojnë on line me Serverin qendror. Sipas zgjedhjes terminalet mund të jenë të lidhur në rrjet LAN ose nëpërmjet Internetit me Serverin.

Sistemi konsiston në modulet e mëposhtme.



SHITJE MOBILE



POROSI MOBILE



RAPORTE NE WEB



PRORetail TERMINAL

Struktura e implementimit të sistemit

Subjekti përkatës mund të ngrejë një strukturë me disa pika dyqane, pika shitje, magazina sipas nevojës apo skemës së vet funksionale.

Dyqanet apo pikat e shitjes mund të jenë fikse apo të lëvizshme si ato për shitjet nga makinat.

Njëkohësisht sistemi mund të shfrytëzohet nga agentët apo shitësit e terrenit pasi mundëson regjistrimin e porosive apo faturave nga pajisjet mobile si p.sh: smartphone apo tablet, pavarësisht nga lloji apo sistemi i tyre.

Përdoruesit e sistemit mund të shfrytëzojnë strukturën e ngritur për të menaxhuar shitjet, blerjet, magazinat apo veprimet financiare. Gjithashtu mund të kryhen lëvizje të mallrave ndërmjet magazinave në mënyrë automatike. Lëvizjet nënkuptojnë dalje malli nga njëra dhe hyrje te tjetra.

Magazinat mund të jenë fikse apo të lëvizshme si ato për shitjet nga makinat.

Për çdo magazinë ruhet inventari përkatës në sasi dhe vlerë duke përdorur metodën e kostos mesatare. Ky mund të shihet dhe të printohet nga përdoruesi në çdo moment të dëshiruar.

Për çdo pikë shitje apo magazinë mund të vendosen çmime shitje të ndryshme të të njëjtit artikull.

Skema e implementimit



DYQAN I LEVIZSHEM



AGJENT I LEVIZSHEM



DYQAN 1



ADMINISTRIM



DYQAN 2



QENDRA E TE DHENAVE

Funksionet sipas moduleve

Shitje mobile

Ky modul mundëson regjistrimin e faturave të shitjes nga pajisjet mobile. Nuk ka kufizim për llojin e tyre mund të përdoren cdo lloj pajisje smartphone apo tablet. Kjo kryhet nëpërmjet ndërfaqes WEB. Mënyra e regjistrimit është shumë e thjeshtë dhe e kuptueshme për përdoruesin.

Porosi mobile

Ky modul mundëson menaxhimin e porosive për shitje nga agjentet në terren. Këto porosi regjistrohen me detajet përkatëse të sasisë dhe klientit. Automatikisht në kohë reale pasqyrohen në терминалет e menaxhimit ku mund të procesohen përkatësisht nga përdoruesit e sistemit. Sistemi mundëson sinjalizimin me imazh dhe zë sa here që vjen porosi e re.

Raportet në WEB

Nëpërmjet këtij moduli të gjithë përdoruesit e autorizuar apo administratorët mund të nxjerrin raportet dhe statistikat e subjektit nga cdo kompjuter apo pajisje që akseson rrjetin e internetit. Nuk kërkon asnjë instalim paraprak në to.

Raportet mund të printohen dhe esportohen në formate të ndryshme elektronike si excel, pdf etj.

ProRetail Terminal

Ky është programi qëndror i menaxhimit të sistemit.

Ky program mund të instalohet në çdo kompjuter i cili do të aksesojë sistemin. Nëpërmjet tij do të menaxhohen të gjitha të dhënat. Programi është shumë i thjeshtë dhe i lehtë për përdoruesit. Është i gjithi në shqip dhe mund të përdohet si për menaxhim ashtu edhe për терминалет e shitjes.

Është i përshtatshëm për tu përdorur edhe nga терминалет me touch screen.

Funksionet e këtij programi do ti gjeni më poshtë.

Funksionet kryesore të programit

Menaxhim i Shitjeve.

Menaxhim i Blerjeve.

Menaxhim i Inventarit. Mund të shikohet në çdo kohë inventari i gjendjes së artikujve në sasi dhe vlerë.

Lëvizje të mallrave në magazina.

Menaxhimi i përbashkët i Subjekteve, kategorizimi sipas llojit të tyre klientë, furnitorë, agjentë, etj. Çdo subjekti pavarësisht llojit të vet mund ti caktohen fatura blerje, shitje, Hyrje dalje malli etj.

Llogari për Subjektet e regjistruar.

Menaxhimi i disa Arkave (Bankave). Pagesa – Arkëtime.

Menaxhimi i Garancisë për artikujt me garanci.

Artikujt për shitje mund të zgjidhen nëpërmjet skanerit me Barcode.

Artikujt mund të importohen nga tabela exceli.

Mund të printohen nëpërmjet programit Barcode -t për artikujt e nevojshëm.

Zgjedhje e llojit dhe formatit të faturës (Shirit 60mm, 80mm, A6, A4).

Për identifikimin e klientëve mund të përdoren edhe karta magnetike ose karta me kode identifikimi.

Mund të aplikohen pikë për klientët e regjistruar të cilët konfigurohen si të shtohen për çdo shitje.

Regjistrim Porosie për shitje.

Nivele aksesi sipas funksioneve për përdoruesit.

Raport kosto-fitim i shitjeve.

Të gjitha veprimet e kryera në program ruhen dhe me emrin e përdoruesit përkatës.

Menaxhohen përdoruesit e programit sipas funksioneve të tyre (si p.sh shitje, furnizime, arkë).

Bëhet ruajtja dhe pasqyrimi i të gjitha Shitjeve të kryera dhe atyre të anuluar.

Raporte për çdo periudhe të zgjedhur kohore për shitjet, furnizimet, sasinë e artikujve të shitur, dhe bilancin financiar.

Printimi i të gjitha raporteve ose exportimi i tyre në Excel.

Të gjitha veprimet e kryera në sistem ruhen me emrin e përdoruesit përkatës që ka hapur sistemin në atë moment. Sistemi ruan dhe pasqyron të gjitha shitjet si ato të kryera edhe ato të anuluar. Sistemi lejon pasqyrimin dhe printimin e aktivitetit financiar ditor dhe inventarit ditor të artikujve të shitur çka e bën të kontrollueshëm dhe të sigurtë aktivitetin ditor.

Sistemi jep mundësinë e regjistrimit dhe menaxhimit të përdoruesve, të dhënave të tyre personale, dhe të drejtave të tyre në sistem, gjithashtu regjistrimin dhe menaxhimin e subjekteve të ndryshme.

Sistemi lejon në çdo moment kontroll të arkave nga përdoruesi i autorizuar dhe gjithashtu kryerjen e veprimeve në arkë (derdhje apo tërheqje). Gjithashtu sistemi ofron raporte mbi shitjet, blerjet, sasinë e artikujve të shitur, dhe bilancin financiar në çdo periudhë kohore të zgjedhur nga përdoruesi si dhe ruajtjen në excel apo printimin e këtyre raporteve dhe mirëmbajta, eksportimi dhe ruajtja e të dhënave të sistemit sa herë që dëshirohet.

Të gjitha funksionet e mësipërme janë bërë të mundur të realizohen online, pa patur nevojën e një lidhjeje fizike ndërmjet terminaleve me serverin qendror.

Funksionet sipas niveleve të përdoruesit

Sistemi jep mundësinë e regjistrimit të niveleve dhe kategorive të ndryshme të përdoruesve me të drejta të përcaktuara dhe të ndara nga administratori i sistemit i cili do ketë akses të plotë në sistem.

Çfarë duhet të keni për ta patur këtë sistem?

Nuk është e nevojshme të keni asnjë pajisje shtesë apo të kryeni ndonjë instalim. Ajo çfarë ju duhet janë vetëm kompjutera me akses interneti. Nuk është e nevojshme kapacitet i lartë i lidhjes së internetit. Min 64 kbps.

Sa duhet të paguani për instalimin fillestar?

Në rastin kur sistemi merret në përdorim nuk është e nevojshme asnjë pagesë fillestare për aktivizimin e tij. Kompanitë do të kryejnë vetëm pagësen periodike mujore.

Sa të sigurta janë të dhënat tuaja?

ProRetail merr përsipër sigurinë e të dhënave. Këto të fundit do të ruhen në serverat e hostimit të ProRetail të cilët janë instaluar në ambiente të sigurta. Këto servera ofrojnë akses me kapacitet të lartë nga Interneti dhe shërbim të përhershëm në 99.99 % të kohës. Gjithashtu pajisjet e ruajtjes janë MIRROR për garanci më të madhe. Backupi i të dhënave kryhet çdo ditë në pajisje të tjera të posaçme.